



ZGJEDHJET E REJA PARLAMENTARE, TË PASHMANGSHME

FAQE 4-5



Për më shumë se një orë presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka takuar të premtën në Presidencë liderët e partive politike, me të cilët ka diskutuar për krijimin e Qeverisë së re të Kosovës ose shkuarjes në zgjedhje të reja. Presidentja Vjosa Osmani ka theksuar se në takimin konsultues, partitë i shprehën qëndrimet e tyre lidhur me mundësinë e daljes nga kriza, por tha se ajo ka kohë deri më 5 nëntor për të vendosur nëse do t'i shpallë zgjedhjet e reja apo do ta mandatojë dikë për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja u shprehën se janë për mbajtjen e zgjedhjeve të reja, por kreu i LV-së, Albin Kurti, nuk u deklarua pas takimit

KURTI RIT PAGËN MINIMALE, PENSIONET DHE SHITESAT E FËMIJËVE, OPOZITA E QUAN MASHTRIM ELEKTORAL F. 3



PSE BËKAN KOALICIONET NËPËR KOMUNA, E JO EDHE PËR QEVERI? F. 7



AKTUALE



ERDOGAN, MERZIT: A S'PO E SHEH GJERMANIA GJENOCIDIN IZRAELIT NË GAZË? F. 2

NJOHJET NGA KENIA, SUDANI E SIRIA MUND TË HAPIN RRUGËN PËR INTERPOL E UNESCO F. 5

SVEÇLA NUK PARAQITET NË GJYKATË, PËRKUNDËR URDHËRARRESTIT F. 5

EKONOMI



AKB-ja SHËNON 23-VJETORIN E THEMELIMIT, VLERËSOHET KONTRIBUTI I SAJ NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT F. 8

BQK-ja MBAN PUNËTORINË INFORMUESE MBI KORNIZËN RREGULLATIVE PËR LICENCIMIN E OPERATORËVE TË SHËRBIMEVE TË KRIPTO-ASETEVE F. 8

SPORT



SUPERLIGA E BASKETBOLLIT NË FUNDJAVË: DERBI MES SKUADRAVE TË PAMPOSHTURA F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ERDOGAN, MERZIT: A S'PO E SHEH GJERMANIA GJENOCIDIN IZRAELIT NË GAZË?

ANKARA, 31 TETOR - Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, e ka kritikuar Gjermaninë lidhur me atë, që ai e quajti injorancë ndaj “gjenocidit të Izraelit” dhe sulmeve në Gazë.

Këto deklarata ai i bëri gjatë konferencës së përbashkët për media me kancelarin gjerman, Friedrich Merz.

Ndasitë mes aleatëve të NATO-s ishin të dukshme gjatë vizitës së parë të Merzit në Turqi, që kur mori detyrën e kancelarit.

Merz tha se Qeveria e tij ka qëndruar pranë Izraelit që nga sulmi i Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - më 7 tetor 2023 dhe se beson se Izraeli po ushtron të drejtën e tij për vetëmbrojtje. “Do të mjaftonte një vendim i juaj për të shmangur viktimat të shumta të panevojshme. Hamasi është dashur që më herët t'i lironte pengjet dhe të dorëzonte armët”, tha ai, duke shtuar se shpreson që lufta ka përfunduar me marrëveshjen e armëpushimit të ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara dhe të mbështetur

nga Turqia.

Erdogan, një prej kritikëve më të zëshëm të ofensivës së Izraelit në Gazë dhe një lojtar kyç në bisedimet për armëpushim, tha se nuk pajtohet me kancelarin Merz. “Hamasi nuk ka bomba e as armë bërthamore, por Izraeli i ka të gjitha këto dhe i përdor këto armë për të goditur Gazën, për shembull ka sulmuar me këto bomba sërish mbrëmë”, tha Erdogan. “Ju, si Gjermani, a i shihni këto? Ju, si Gjermani, a nuk i ndiqni këto ngjarje? Përveç se sulmon Gazën, Izraeli po ashtu gjithmonë ka synuar që të shtypë Gazën përmes urisë dhe gjenocidit”, tha udhëheqësi turk. Një hetim i Kombeve të Bashkuara ka konstatuar se Izraeli ka kryer gjenocid në Gazë, duke argumentuar se vrasjet, rrethimet dhe shkatërrimet janë kryer me qëllim “shkatërrimin e palestinezëve” në këtë enklavë. Disa grupe të tjera izraelite dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kanë dalë me një përfundim të ngjashëm.

Izraeli mohon akuzat për gjenocid, duke i cilësuar si të motivuara politikisht dhe thotë se



fushata e tij ushtarake ka në shënjestër Hamasin, e jo popullatën civile të Gazës. Ai po ashtu pretendon se merr masa për të minimizuar dëmet te civilët. Merz ka kritikuar veprimet e Izraelit në Gaza dhe këtë vit Gjermania pezulloi eksportet ushtarake atje, duke përmendur si motiv situatën e përkeqësuar humanitare në Rripin e Gazës. Megjithatë, ai nuk ka shprehur

mbështetje për akuzat për gjenocid, duke argumentuar se kritika ndaj Izraelit nuk duhet të shndërrohet në një pretekst për antisemitizëm.

Erdogan tha se ende beson se Gjermania dhe Turqia mund të bashkëpunojnë për t'i dhënë fund zisë së bukës dhe për të siguruar dërgesa me ndihma për Gazën.

Ai gjithashtu përmendi

mundësinë që aleatët e NATO-s të përqendrohen në projekte të përbashkëta në industrinë e mbrojtjes dhe përsëriti dëshirën e Ankarasë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian.

Merz tha se sheh Turqinë si një partnere të ngushtë të BE-së dhe se dëshiron të zhvillojë marrëdhënie dypalëshe ekonomike, përfshirë në sektorin e transportit dhe migracionin.

HEGSETH I THOTË KINËS SE SHBA-JA DO T'I MBROJË “ME VENDOSMËRI” INTERESAT E VETA

Uashington, 31 tetor- Shtetet e Bashkuara do t'i “mbrojnë me vendosmëri interesat e veta”, tha sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, gjatë një takimi të premtën në Kuala Lumpur me ministrin e Mbrojtjes së Kinës, Dong Jun.

Takimi, që pasoi një telekonferencë në shtator, ishte një tjetër shenjë e përmirësimit gradual të komunikimit ushtarak midis dy palëve, në një periudhë tensionesh të larta rajonale dhe rritjes së pranisë ushtarake në gjithë Azinë Lindore.

Hegseth i tha ministrin kinez të Mbrojtjes Kombëtare se Shtetet e Bashkuara janë të shqetësuara për veprimtarinë e Kinës në Detin e diskutueshëm të Kinës Jugore dhe përreth Tajvanit.

Në një postim në X, ai e përshkroi takimin si “të mirë dhe konstruktiv”. “Ne do t'i



vazhdojmë bisedimet me Ushtrinë Çlirimtare Popullore për çështje me rëndësi të përbashkët”, shkroi ai pas takimit, i cili u zhvillua në kuadër të mbledhjes së ministrave të mbrojtjes të ASEAN-it në kryeqytetin e Malajzisë. “Shtetet e

Bashkuara nuk kërkojnë konflikt, por do të vazhdojnë t'i mbrojnë me vendosmëri interesat e veta dhe të sigurohen se i kanë kapacitetet e nevojshme në rajon për ta bërë këtë”, shtoi ai. Ministria kineze e Mbrojtjes tha se Dong i kishte kërkuar

Hegsethut që Shtetet e Bashkuara të jenë të kujdesshme në fjalë dhe veprime lidhur me Tajvanin dhe të mbajnë një qëndrim të qartë kundër “pavarësisë” së tij.

Ministria citoi Dongun të ketë thënë se Kina është e përkushtuar ndaj zhvillimit paqësor, ndërkohë që mbron me vendosmëri interesat e sigurisë kombëtare të vendit. “Ajo ka aftësinë e plotë për t'iu përgjigjur me qetësi çdo shkeljeje apo provokimi”, thuhet në deklaratë.

Këto deklarata vijnë pasi presidenti amerikan, Donald Trump, tha të enjten se çështja e Tajvanit nuk ishte përfshirë në takimin e tij me presidentin kinez, Xi Jinping, në Busan të Koresë së Jugut, ndërsa deklarata zyrtare kineze gjithashtu nuk e përmendi Tajvanin.

Kina i ka rritur vazhdimisht dislokimet ajrore, detare dhe të

rojeve bregdetare rreth Tajvanit, të cilin e konsideron pjesë të veten. Ajo e cilëson presidentin e Tajvanit, Lai Ching-te, si “separatist”.

Lai i kundërshton pretendimet e sovranitetit të Pekinit, duke thënë se vetëm populli i ishullit mund të vendosë për të ardhmen e tij.

Pentagoni ka kërkuar përmirësim të komunikimit me Kinën në lidhje me modernizimin e ushtrisë së saj dhe qëndrimin rajonal, duke përfshirë transparencë më të madhe mbi ndërtimin e arsenalit bërthamor dhe më shumë diskutime në nivel komandash ushtarake.

Ministria kineze e Mbrojtjes tha se Dong i kishte thënë Hegsethut se takimi Trump-Xi kishte ofruar “udhëzim strategjik” për përmirësimin e marrëdhënieve në fushën e mbrojtjes dhe se tani duhet të merren “masa praktike”.

Andrew humb titullin e princit

LONDËR, 31 TETOR - Monarku britanik, Charles III ka nisur procesin zyrtar për të hequr titullin e princit për vëllain e tij, Andrew, i cili po ashtu do të largohet nga shtëpia e tij në Uindsor dhe do të zhvendoset në Sandringam.

Pallati Buckingham tha se Andrew

është pajtuar që të largohet nga prona mbretërore, teksa lidhjet e tij me financierin, Jeffrey Epstein - që ishte ekspozuar si pedofil - vazhdojnë të shkaktojnë polemika.

Andrew mohon akuzat, por Pallati mbretëror ka vlerësuar se ka pasur “mungesë serioze të

gjykimit”.

Përmes një njoftimi, Pallati tha se “princi Andrew nga tani do të njihet si Andrew Mountbatten Windsor”. “Kontrata e tij e qirasë në pronën mbretërore deri më tani i kishte ofruar atij mbrojtje ligjore që të jetonte aty. Tashmë është dorëzuar njoftimi zyrtar për

ta dorëzuar pronën dhe ai do të zhvendoset në një pronë private. Këto masa vlerësohen të domosdoshme, pavarësisht faktit se ai vazhdon t'i mohojë akuzat ndaj tij”, u tha në njoftim.

Në janar të vitit 2022, Andrew kishte humbur titujt ushtarakë dhe patronazhet, pasi atëbotë ai



kishte dështuar ta binte një gjykatës amerikan që të hidhte poshtë një padi civile ndaj tij, në të cilën ai akuzohej për abuzim seksual.

ZGJEDHJET E REJA PARLAMENTARE, TË PASHMANGSHME

Për më shumë se një orë presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka takuar të premten në Presidencë liderët e partive politike, me të cilët ka diskutuar për krijimin e Qeverisë së re të Kosovës ose shkuarjes në zgjedhje të reja. Presidentja Vjosa Osmani ka theksuar se në takimin konsultues, partitë i shprehën qëndrimet e tyre lidhur me mundësinë e daljes nga kriza, por tha se ajo ka kohë deri më 5 nëntor për të vendosur nëse do t'i shpallë zgjedhjet e reja apo do ta mandatojë dikë për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja u shprehën se janë për mbajtjen e zgjedhjeve të reja, por kreu i LV-së, Albin Kurti, nuk u deklarua pas takimit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 31 TETOR - Për më shumë se një orë presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka takuar të premten në Presidencë liderët e partive politike, me të cilët ka diskutuar për krijimin e Qeverisë së re të Kosovës ose shkuarjes në zgjedhje të reja. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja u shprehën se janë për mbajtjen e zgjedhjeve të reja, por kreu i LV-së, Albin Kurti, nuk u deklarua pas takimit. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se në takimin konsultues, partitë i shprehën qëndrimet e tyre lidhur me mundësinë e daljes nga kriza, por tha se ajo ka kohë deri më 5 nëntor për të vendosur nëse do t'i shpallë zgjedhjet e reja apo do ta mandatojë dikë për formimin e Qeverisë së re të Kosovës. Kreu i LV-së, Albin Kurti, sipas Osmanit, i ka kërkuar që të takohen sërisht para 5 nëntorit. "Kurti ka kërkuar që të më takoj edhe njëherë para se të skadojë afati 10-ditor. Do të vijnë me propozim apo jo është çështje e tyre", tha ajo. Osmani tha se partitë mund të duan të mbahen zgjedhje të reja, por aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese e obligojnë atë që të shmangë mbajtjen e zgjedhjeve. "Aktgjykimet e Kushtetueses thonë që presidentja duhet të

bëjë çmos t'i evitojë zgjedhjet. Partitë politike i kanë qëndrimet e tyre, detyrimi i presidentes është tjetër. Atë detyrim unë duhet ta kryej", tha ajo, duke shtuar se duhet të dëshmojë se ka bërë çmos për t'i shmangur zgjedhjet e reja. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se gjatë takimit me udhëheqësit politikë e ka shtruar çështjen e procedimit përpara të buxhetit dhe Planit të Rritjes të BE-së, i cili duhet të ratifikohet në Kuvend, në mënyrë që vendi të mund t'i përfitojë 800 milionë eurot e ndara nga Brukseli. Sa i përket buxhetit, Osmani tha se në bazë të nenit 79 të Kushtetutës, ajo mund ta dërgojë në Kuvend propozimin për zgjatje buxhetore e jo për një buxhet të ri, në mënyrë që me një zgjatje të tillë, vendi të mund të ketë para deri më 31 mars 2026.

Ajo tha se në takim u shprehën shqetësime lidhur me procedurat për propozimin e një buxheti të ri nga Qeveria, duke thënë se zgjidhja mund të jetë që ajo të dërgojë në Kuvend propozimin për zgjatjen buxhetore për të parandaluar një krizë financiare. "Kishte shqetësime rreth procedurave, është neni 79 i Kushtetutës, atë detyrim ta marrë unë dhe si presidente t'i procedojë zgjatjet

buxhetore, meqë nuk i kam të drejtat e kufizuara", tha Osmani. "Shpresa ishte që mund të ketë reflektim" dhe të procedohet buxheti, por edhe ratifikimi i Planit të Rritjes, shtoi e para e vendit. Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, nuk është deklaruar për mediet të premten pas takimit që zyrtarët politikë zhvilluan me presidenten e vendit, Vjosa Osmani. Pas takimit, ai u tha gazetarëve se i duhet të shkojë me shpejtësi. Në këtë takim është bërë me dije se Kurti ka kërkuar disa ditë kohë për të parë mundësitë nëse mund të formojë një shumicë parlamentare. Kurti dështoi më 26 tetor të merrte besimin e Kuvendit për ekzekutivin e ri. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në deklarimin për medie ka thënë se në takim është bërë e qartë se askush nuk mund ta sigurojë shumicën për të formuar qeverinë. Sipas tij, zgjedhjet e reja tashmë janë të imponuara. "Një situatë të tillë ka muaj që e kemi paralajmëruar. Në këtë moment, rruga përpara është vetëm shpallja e zgjedhjeve të reja". Ai ka thënë se pavarësisht pse ka bërë përpjekje që ta sigurojë shumicën me partitë që në legjislaturën e kaluar ishte në

opozitë, diçka e tillë nuk është arritur. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se në këtë takim "u bë e qartë nga përfaqësuesit e partive parlamentare se nuk ka shumicë parlamentare". "Tani i takon presidentes që deri të mërkurën, më 5 nëntor, të përcaktojë se a ka shumicë apo jo", është shprehur ai. Abdixhiku ka theksuar se "sa më parë që i shpallim zgjedhjet, i shmangim krizat që mund t'i vihen vendit". "Nuk folëm për data, as për marrëveshje politike. Këtu ishim për t'i dhënë qëndrimet e partive dhe presidentja të vlerësojë a ka numra për një shumicë". Sipas tij, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, pati pretendime se ndoshta duhet provuar edhe një herë që ta formojë qeverinë, "por shumica, përfaqësuesit e 52 deputetëve shqiptarë, thanë se nuk ka shumicë". Kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se vendi nuk ka kohë për të humbur dhe duhet që sa më shpejt të mbahen zgjedhjet e reja. Pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, Haradinaj tha se ajo ka afat që deri më 5 nëntor të vendosë nëse do të mandatojë dikë tjetër për të formuar ekzekutivin e ri apo do të shpallë zgjedhjet e reja.

Haradinaj ka pohuar se presidentja ka mundur që edhe sot të shpallë datën e zgjedhjeve të reja, por kreu i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, kërkoj disa ditë kohë për të tentuar që të bëjë sërisht shumicën. "Do të ishte në interes të Kosovës që data e zgjedhjeve të caktohet ma shpejt, brenda 30 ditësh", ka thënë ai, duke shtuar se data më e afërt është 7 dhjetori. "Qëndrimi i AAK-së që ne nuk duam të humbin kohë, në afatin e parë kushtetues të veprohet dhe të mbahen zgjedhjet", ka theksuar Haradinaj. Ai ka thënë se nëse zgjedhjet nuk mbahen më 7 dhjetor, atëherë data e dytë më e shpejt është 14 dhjetori, duke argumentuar se vendit i duhet një qeveri e re sa më shpejt në mënyrë që të mund të miratojë buxhetin për vitin e ardhshëm. Takimi i presidentes Vjosa Osmani me liderët partiakë të premten u zhvillua gati një javë pasi Kuvendi s'e votoi Qeverinë Kurti 3. Asnjë parti nuk e ka fituar shumicën në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit për të qeverisur e vetme dhe ka mungesë vullneti mes partive për bashkëqeverisje. Osmani mund ta mandatojë dikë tjetër për të tentuar ta bëjë qeverinë e re, ose të shpallë zgjedhje të reja.



QEVERIA NË DETYRË E MIRATON BUXHETIN PËR VITIN 2026

KURTI RRIT PAGËN MINIMALE, PENSIONET DHE SHITESAT E FËMIJËVE, OPOZITA E QUAN MASHTRIM ELEKTORAL

Qeveria në detyrë e Kosovës e ka miratuar buxhetin për vitin 2026 të premten, i cili kap një shifër rekorde prej rreth 4 miliardë euro, me gjithë pasigurinë se Kuvendi mund ta shqyrtojë miratimin e tij. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se buxheti i ri parasheh rreth 1 miliard euro investime kapitale, derisa ka theksuar se paga minimale do të rritet nga 350 euro sa është aktualisht, në 500 euro, kurse nga 1 nëntori pensioni minimal do të rritet nga 120 në 150 euro, si dhe shtesat për të gjithë fëmijët nga 0-16 vjeç për 50 për qind. Liderët e opozitës këto vendime të Kurtit i kanë konsideruar mashtrim elektoral

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 31 TETOR - Qeveria në detyrë e Kosovës e ka miratuar buxhetin për vitin 2026 të premten, i cili kap një shifër rekorde prej rreth 4 miliardë euro, me gjithë pasigurinë se Kuvendi mund ta shqyrtojë miratimin e tij. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se buxheti i ri parasheh rreth 1 miliard euro investime kapitale. “Me këtë buxhet do të ketë pagë të 13-të për të gjithë punëtorët e sektorit publik. Është përfshirë edhe zbatimi i rritjes së pagës bazë për 0.5 për qind për çdo vit përvojë pune në sektorin publik”, ka thënë Kurti. Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, tha se buxheti i ri është 10 për qind më i lartë sesa ai paraprak.

Gjatë kësaj mbledhjeje, Qeveria në detyrë tha se paga minimale do të rritet nga 350 euro sa është aktualisht, në 500 euro. Rritja do të bëhet në dy faza gjatë vitit të ardhshëm. Ndërsa duke nisur nga 1 nëntori i këtij viti, pensioni minimal do të rritet nga 120 në 150 euro, si dhe shtesat për të gjithë fëmijët nga 0-16 vjeç për 50 për qind, nga 20 në 30 euro. Kurti ka thënë se nga kjo rritje do të përfitojnë rreth 200.000 pensionistë dhe mbi 400.000 fëmijë do të përfitojnë nga këto rritje. Qeveria në detyrë, po ashtu, i miratoi edhe buxhetet për vitin 2025 për Komunën e Prishtinës, Gjilanit dhe atë të Zubin Potokut. Këto komuna kanë funksionuar me buxhet të vitit 2024 deri tani, meqë janë vonuar në miratimin e buxhetit të ri në kohë.

Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, tha në mbledhjen e Qeverisë në detyrë se rritja për pagën minimale vjen pas “analizave që kemi bërë sa i përket ndikimit që mund të ketë edhe në sektorin privat, te ndërmarrjet, por edhe te punonjësit”. Kjo rritje prek rreth 150.000 të punësuar në sektorin privat, sipas Muratit. “Pas diskutimeve që kemi pasur dhe propozimeve dhe sugjerimeve që kemi marrë nga përfaqësues të sindikatave dhe bizneseve, propozimi ynë është që paga minimale për vitin e ardhshëm të bëhet 500 euro, apo konkretisht 3 euro për orë pune”, shtoi ai. Deri në fuqizimin e Ligjit të ri në vitin 2023, paga minimale në Kosovë ishte 130 euro për punëtorët nën 35 vjeç dhe 170 euro për punëtorët deri në 65 vjeç.

Ajo u rrit në 350 euro në verën e vitit 2024. Kosova, deri më tani e ka pasur pagën minimale më të ulët në Evropë, 350 euro, ndërsa Luksemburgu më të lartën, 2.571 euro. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka folur për rritjen e pensionit dhe shtesat e fëmijëve. “Përveç rritjes së pagës në sektorin publik, kemi lajm të mirë edhe për sektorin privat. Nga Ministria e Financave kemi propozimin edhe për rritjen e pagës minimale, rritje kjo që do të ndikojë në 150 mijë të punësuar. Ashtu siç kam premtuar, sot ka lajme të mira edhe për pensionistët. Pensioni minimal nga 120 euro do të bëhet 150 euro duke filluar nga muaji nëntor që fillon nesër. Kjo rritje prek rreth 200 mijë pensionistë, kategoritë e pensioneve bazike, personat me aftësi të kufizuara, për të rritur, fëmijë, si dhe pensionin invalidor të punës. Siç e dini, kam premtuar edhe lajm të mirë për nënat që marrin shtesa për fëmijë. Nga muaji nëntor, shtesat për të gjithë fëmijët nga 0 - 16 vjeç do të rriten për 50 për qind. Pra, një nënë me dy fëmijë që këtë muaj ka marrë 40 euro, nga muaji i ardhshëm do t'i marrë 60 euro. Një nënë me katër fëmijë do të marrë 180 euro në muaj”, ka theksuar Kurti.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka reaguar pas miratimit të buxhetit nga qeveria në detyrë e Kurtit. Ai ka thënë se: “Thesi i mashtrimeve të një ‘babadimri’ që kurrë s’erdhi për qytetarët e Kosovës, sado që premtoi çdo vit për pesë vjet, s’mundet për ta rikthyer besimin e humbur te qytetarëve e as nuk mund te arrijë qëllimin e blerjes së votës për balotazh dhe për zgjedhje parlamentare”. Krasniqi ka thënë se krejt ato që u prezantua në mbledhjen e fundit të kësaj qeverie, e që s’u bënë pesë vjet me radhë, do të bëhen: më mirë, më shumë e më shpejt, por me qeverinë e ardhshme, pa Albin Kurtin e pa Vetëvendosjen. “Mashtrimi elektoral nuk kalon. Uji i turbullt s’piket dy herë!”, ka shkruar Krasniqi. Lidhja Demokratike e Kosovës e konsideron vendimin për miratimin e buxhetit për vitin 2026 nga një qeveri pa mandat dhe pa legjitimitet si një akt të paprecedent politik dhe institucional, një përpjekje të dëshpëruar për blerje votash dhe manipulim të procesit zgjedhor vetëm një javë para balotazhit të zgjedhjeve komunale dhe pak javë para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. “Çdo tentim për të përdorur buxhetin e shtetit si instrument elektoral është i papranueshëm. Asnjë euro e

NJOHJET NGA KENIA, SUDANI E SIRIA MUND TË HAPIN RRUGËN PËR INTERPOL E UNESCO

Prishtinë, 31 tetor- Ish-ambasadori i Kosovës në Suedi, Lulzim Peci, ka vlerësuar se viti 2025 do të mbahet mend si një vit i rëndësishëm për Kosovën, pas tri njohjeve të reja si shtet i pavarur dhe sovran nga Kenia, Sudani dhe Siria.

Sipas Pecit, këto njohje kanë krijuar një “dinamikë të re të legjitimitetit ndërkombëtar të shtetësisë së Kosovës”, pas një periudhe të gjatë stagnimi që kishte nisur pas njohjes nga Izraeli në vitin 2020.

Ai ka theksuar se ndryshimet gjeopolitike në Lindjen e Mesme dhe në skenën globale - si dobësimi i ndikimit rus pas agresionit në Ukrainë, ndryshimet në politikën amerikane, rënia e ndikimit të Iranit dhe afrimi midis Turqisë dhe Arabisë Saudite - kanë



ndikuar në këtë zhvillim pozitiv për Kosovën. Peci ka theksuar se këto njohje

mund të hapin rrugën për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare si

INTERPOL dhe UNESCO, por ka paralajmëruar se për këtë nevojitet mbështetje e fuqishme

nga vendet perëndimore, e cila, sipas tij, “aktualisht është e vështirë për t’u arritur”.

Ai ka bërë thirrje për krijimin e një “leadershipi qeveritar progresiv e liberal, me agjendë të qartë reformuese dhe të politikës së jashtme”, që do të mund të siguronte këtë mbështetje.

Sipas Pecit, me përkrahjen e aleatëve perëndimorë, Kosova do të mund të bëjë hapa përpara drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës dhe kapërcimit të pengesave që vijnë nga pesë vendet e Bashkimit Evropian që ende nuk e njohin pavarësinë e saj. “Nuk e kemi komoditetin që për shkak të një lisi të mos e shohim malin”, ka shkruar në “Facebook” Peci, duke theksuar nevojën për vizion strategjik në politikën e jashtme të Kosovës.

SVEÇLA NUK PARAQITET NË GJYKATË, PËRKUNDËR URDHËRARRESTIT

PRISHTINË, 31 TETOR - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, nuk ishte prezent, të premten, në seancën gjyqësore për rastin e njohur si “Gazi lotsjellës”, e cila ishte paraparë të mbahej në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Sveçla, i akuzuar së bashku me Salih Zybën, Fitore Pacollin dhe Drita Millakun, kishte njoftuar gjykatën përmes emailit lidhur me mungesën e tij. Më parë, për të ishte lëshuar edhe urdhërarrest, por gjykata e pranoi shpjegimin e tij me shkrim.

Gjyqtari Sabit Sadikaj konstatoi se, për shkak të mungesës së Sveçlës, nuk ishin krijuar kushtet për mbajtjen e seancës. Ai ka thënë se ndaj secilit që mungon seancën e radhës, do të lëshohet urdhërarrest dhe kërkesë për caktim të masës së paraburgimit.

“Pasi i pandehuri Xhelal Sveçla e ka njoftuar gjykatën me shkrim duke arsyetuar mungesën, seanca e sotme nuk mbahet, e njëjta do të shtyhet për 16 janar. Te Sveçla gjykata dërgon ftesë të rregullt. Secila palë që mungon, ndaj asaj pale të lëshohet urdhërarrest dhe kërkesë për caktim të masës së paraburgimit”, ka thënë gjyqtari Sabit Sadikaj.

Gjatë seancës, gjykata kërkoi sqarime edhe nga Salih Zyba dhe Fitore Pacolli për mungesën e tyre në seancën e kaluar. Të dy deklaruan se kanë arsye të justifikuara dhe premtojnë t’i dorëzojnë ato me shkrim.

Në përfundim, gjyqtari vendosi që seanca të shtyhet, ndërsa data e re do të caktohet nga gjykata. Rasti “Gazi lotsjellës” lidhet me hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend në mars të vitit 2018.



Gjykata Themelore e Prishtinës kishte konfirmuar aktakuzën më 6 qershor 2024 ndaj Sveçlës,

Millakut, Zybës dhe Pacollit, e më pas vendimi ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit.

Në seancën fillestare më 26 mars 2024, katër të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm.

buxhetit nuk mund të shndërrohet në mjet për blerje votash, asnjë plan financiar nuk mund të shërbejë si mburojë për dështimet qeveritare dhe asnjë vendim i marrë në këtë fazë nuk mund të ketë legjitimitet demokratik”, thuhet në reagimin e LDK-së, duke theksuar se mirëqenia sociale dhe rritja e mbështetjes për qytetarët duhet të jenë rezultat i politikave të qëndrueshme, planifikimit afatgjatë dhe qeverisjes së përgjegjshme e jo spektakël populist i orëve të fundit për të mbuluar dështimet. Edhe kryetari i AAK-së ka reaguar për miratimin e

buxhetit për vitin 2026 nga qeveria në detyrë e Albin Kurtit, ku u rrit paga minimale, pensionet për të moshuar dhe shtesat për fëmijë. “Shumë vonë, shumë pak. Marre! Kjo rritje është dashur të ndodhë para shumë vitesh. Në takimin e parë të qeverisë sonë, pensioni bazik do të jetë 200 euro, ndërsa paga minimale do të jetë 600 euro. Shtesat për të gjithë fëmijët nga 0-16 vjeç do të kenë rritje të konsiderueshme. Nënata me dy fëmijë do të marrin 100 euro, ndërsa nënata me katër fëmijë do të marrin 300 euro në muaj”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Katërmbëdhjetë organizata joqeveritare (OJQ) përmes një reagimi të përbashkët, kanë vlerësuar se veprimi i qeverisë në detyrë gjatë procedimit dhe miratimit të projektligjit të buxhetit bie në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin e qeverisë dhe vetë Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kjo për faktin se, sipas këtij reagimi, në këtë mbledhje të qeverisë kanë votuar personat që janë të certifikuar si deputetë në Kuvendin e Kosovës.

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka reaguar ndaj

deklarimeve të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, i cili në mbledhjen e Qeverisë foli për rritje të pensioneve dhe pagave, por edhe kësaj radhe nuk ka përmendur fare pensionet e veteranëve të luftës. “Në një kohë kur vendi po shkon drejt zgjedhjeve, Qeveria në detyrë po mundohet të krijojë përshtypje mashtruese me premtime për rritje që nuk mund të realizohen pa buxhet të miratuar nga Kuvendi. Por edhe në këtë tentativë për mashtrim të qytetarëve, ku u përmendën të gjitha kategoritë shoqërore, veteranët e luftës së UÇK-së u anashkaluan sërish


qëllimisht. Kjo është dëshmi e qartë se diskriminimi ndaj atyre që sakrifikuan më së shumti për lirinë e Kosovës po vazhdon. Në vend që të përmirësohet trajtimi i dinjitetshëm për veteranët, Qeveria në largim po tenton t’i harrojë ata plotësisht, madje edhe në momentet e fundit të mandatit. OVLUÇK kërkon që çdo qeveri e ardhshme të kthejë atë që na takon me ligj, përfshirjen e pensioneve të veteranëve në rritjen e pagës minimale, të drejtë që u mohua padrejtësisht nga qeveria Kurti me ndihmën e Listës Serbe”, thuhet në reagimin e OVLUÇK-së.

LDK-ja dhe PDK-ja arrijnë koalicion para balotazhit në Gjilan

GJILAN, 31 TETOR - Kandidati i LDK-së për kryetar të Gjilanit, Arbër Ismajli, ka njoftuar tw premten se kanë arritur një marrëveshje politike për bashkëpunim me kryetarin e degës së PDK-së në Gjilan, Riad Rashitin. Ismajli përmes një postimi në “Facebook,” theksoi se ky është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një qeverisjeje që bashkon. “Sot nënshkruam një marrëveshje politike për

bashkëpunim dhe qeverisje të përgjegjshme në Gjilan, që reflekton vullnetin e qytetarëve për unitet, profesionalizëm dhe mirëqenie. Ky është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një qeverisjeje që bashkon, që punon me transparencë dhe që vendos interesin publik mbi gjithçka. Qeverisja që duam është ajo që i shërben qytetarëve pa dallime, me vizion dhe përgjegjësi. Falënderim të veçantë për z.

Lutfi Haziri, kryetar i degës së LDK-së në Gjilan, dhe z. Riad Rashiti, kryetar i degës së PDK-së në Gjilan, për gatishmërinë, vizionin dhe frymën e bashkëpunimit që po e ndërtojmë bashkë për të mirën e qytetit tonë. Gjilani i ri meriton stabilitet, zhvillim dhe udhëheqje që bashkon. Dhe këtë do ta bëjmë bashkë me besim në Zot, me përgjegjësi dhe përkushtim ndaj qytetarëve tanë”, ka shkruar Ismajli.



VDES ISH-KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, FATOS NANO

TIRANË, 31 TETOR - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Fatos Nano, ka vdekur të premten në moshën 73-vjeçare. Ai kishte qenë i shtruar prej disa ditësh në një spital privat në Tiranë, ku po trajtohej për probleme shëndetësore. Ai prej kohësh kishte probleme me mushkëritë, ndërkaq gjendja e tij shëndetësore u përkeqësua ditët e fundit, raporton transmetuesi publik i Shqipërisë. Ish-kreu i Partisë Socialiste edhe para dy vjetësh ishte përballur me probleme shëndetësore, përkatësisht kishte pasur probleme me frymëmarrjen. Atëbotë, ai iu nënshtrua një ndërhyrjeje kirurgjikale. Në kohën kur ai ishte i shtruar në spital para dy vjetësh, kreu i Qeverisë shqiptare, Edi Rama, i kishte ndarë medaljen e mirënjohjes publike për kontributin “në ndërtimin e shtetit kushtetues e demokratik në Shqipëri”. Nano kishte qenë themelues i PS-së, parti që e udhëhoqi deri më

2005, kur dhe vendosi të largohej nga politika.

Kush ishte Fatos Nano?

Nano u lind më 16 shtator 1952 në Tiranë. Diplomoi për ekonomi politike më 1974 në Tiranë, shkruan Top Channel. Në dhjetor të vitit 1990, ai ishte emëruar sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, dhe një muaj më vonë zëvendës-kryeministër në Qeverinë e Adil Çarçanit. Në fund të shkurtit të vitit 1991, Ramiz Alia e caktoi atë kryeministër dhe Nano kishte për mandat që të përgatiste trazicionin e Shqipërisë drejt demokracisë liberale dhe ekonomisë së tregut. Pas zgjedhjeve të 31 marsit 1991, Nano u mandatua kryeministër, detyrë të cilën e mbajti për disa javë, kur dha dorëheqjen për shkak të grevave që kishin nisur në mbarë Shqipërinë. Pas ardhjes në pushtet të demokratëve, më 30 korrik 1993, ai ishte arrestuar nën akuzat për



“shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh zyrtare lidhje me ndihmën italiane” dhe nëntë muaj më vonë u dënua me 12 vjet burg. Gjatë trazirave të vitit 1997, ai u lirua nga burgu dhe u krye në krye të PS-së. Tre muaj pas daljes nga burgu, ai mposhti demokratët dhe ktheu në pushtet socialistët, duke e mbajtur pushtetin për tetë vjet. Ai mbajti postin e kryeministrit vetëm për një vit dhe dha dorëheqje më 28 shtator 1998. Pavarësisht se u largua nga Qeveria, ai vazhdoi drejtimin e PS-së. Nano u bë sërisht kryeministër më 31 korrik 2002 deri në humbjen e zgjedhjeve në qershor të vitit 2005. Pas largimit nga politika, ai kishte jetuar mes Vjenës dhe Tiranës. Ai kishte qenë i martuar për 25 vjet me Rexhina Nanon, me të cilën ka dy fëmijë. Pas divorcit, më 2002 ai u martua me Xhoana Nanon.

GASHI: DIASPORA AKADEMIKE, PARTNER STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

PRISHTINË, 31 TETOR - Zëvendësministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, ka marrë pjesë në forumin “Bashkë në Shkencë: Universiteti i Prishtinës dhe Diaspora Akademike” organizuar nga Universiteti i Prishtinës, ku u diskutua për mënyrat e avancimit të bashkëpunimit ndërmjet diasporës akademike shqiptare dhe institucioneve të arsimit të lartë në vend. Në fjalën e saj, zëvendësministria Gashi theksoi se diaspora shqiptare përfaqëson një potencial të jashtëzakonshëm intelektual e profesional, që mund të kontribuojë ndjeshëm në forcimin



e sistemit arsimor dhe shkencor të Kosovës. Ajo tha se, ndonëse ekziston një bazë e mirë e studiuesve të angazhuar jashtë vendit, ende mungon një platformë e qëndrueshme dhe e koordinuar që do të mundësonte lidhje të vazhdueshme ndërmjet

diasporës akademike dhe universiteteve në Kosovë. “Dëshira jonë është që Universiteti i Prishtinës, si institucion publik dhe bartës i traditës akademike në vend, të marrë rolin udhëheqës në zhvillimin e kësaj platforme, duke krijuar ura bashkëpunimi me akademikët shqiptarë anembanë botës”, shtoi zëvendësministria Gashi. Ndër të tjera, zëvendësministria Gashi përmendi nisma të suksesshme si Shkolla Verore e Universitetit të Prishtinës, që ka luajtur një rol të rëndësishëm në rikthimin e diasporës akademike dhe në krijimin e mundësive për bashkëpunim me studentët dhe

profesorët vendorë. Po ashtu, zëvendësministria Gashi foli edhe për rëndësinë e partneriteteve ndërkombëtare që Universiteti i Prishtinës ka me universitetet ndërkombëtare dhe institucioneve tjera përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke theksuar se ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë është një ndër prioritetet kryesore të politikës së jashtme kulturore dhe arsimore të Kosovës. Ajo nënvizoi se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e sheh veten si lehtësuese dhe mbështetëse të këtyre nismave, për të ndërtuar një ekosistem të hapur dhe bashkëpunues, ku

konkurrenca shihet si mundësi zhvillimi dhe jo si rrezik. Në këtë kuadër, Gashi prezantoi edhe programin “Citizen Diplomacy Fellowship”, që u ofron profesionistëve të mërgatës mundësinë të angazhohen në institucione të Kosovës, duke kontribuar me njohuritë dhe përvojën e tyre profesionale. “Rezultatet e qëndrueshme ndërtohen hap pas hapi. Prandaj, ne do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim për të ndërtuar një platformë bashkëpunimi që reflekton ndikim pozitiv e të matshëm në sistemin tonë arsimor”, tha në mbyllje zëvendësministria Gashi.

Përparimi e Beka bashkë në koalicion: ‘Faleminderit Beko, i grahim përpara’

Prishtinë, 31 tetor- Kandidati i AAK-së për kryetar të Prishtinës, Bekë Berisha, ka postuar një video me kryetarin aktual të

kryeqytetit, njëherësh kandidat i LDK-së edhe për një mandat, Përparim Rama. Ky i fundit e ka falënderuar Berishën për mbështetjen.

“Faleminderit Beko, i grahim përpara”, ka thënë Rama në këtë video. AAK-ja në Prishtinë ka marrë 10 mijë vota, kështu që

Ramës ia rritë gjasat për fitore në garën për balotazh, ku do të përballet me kandidatin e LV-së, Hajrulla Çeku.



PSE BËKAN KOALICIONET NËPËR KOMUNA, E JO EDHE PËR QEVERI?



Kosova rrezikon t'i provojë edhe një palë zgjedhje - të tretat - brenda 2025-tës, për shkak të pamundësisë së partive politike për të arritur konsensus në nivelin qendror. Mirëpo, duket se inatet dhe mospajtimet ekzistojnë vetëm në atë pikë, pasi në nivelin lokal përfaqësuesit partiakë janë duke bashkëpunuar dhe duke lidhur koalicione për balotazhin e 9 nëntorit. Çfarë tregon kjo?

PRISHTINË, 31 TETOR - Koalicionet mes partive politike në nivelin lokal kanë ndodhur edhe në të kaluarën, e po ndodhin edhe tash. Për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) arritën koalicion në Vushtrri. LDK-ja dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) bënë koalicion në Fushë-Kosovë. LV-ja dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) lidhën koalicion në Fushë-Kosovë, Prizren e Junik. Në parim, nuk do të duhej të ishte problem që partitë bashkëpunojnë. Bile, kjo linjë do të duhej të ndiqej edhe në nivelin qendror. Por, këtë herë, larg duartrokitjeve, koalicionet për balotazh po priten me befasi, po gjykohen dhe po dënohen - me raste edhe nga vetë liderët partiakë. Për Visar Ymerin, drejtor

ekzekutiv i Institutit për Politika Sociale "Musine Kokalari", situata është e qartë: dinamikat politike janë të ndryshme mes nivelit qendror dhe atij lokal, mirëpo koalicionet aktuale janë vështirë të kuptueshme, për shkak se polarizimet në nivel qendror janë shumë të mëdha. "Në njërën anë ka parti, të cilat LV-ja thotë se janë bashkëpunëtore të [Millan] Radoiçiqit e kështu me radhë, dhe në anën tjetër i kemi partitë e ish-opozitës, siç është shembull AAK-ja, që thotë se puna e kryeministrit [në detyrë, Albin] Kurti ka qenë në interes të Serbisë dhe Rusisë. Atëherë si është e mundshme që këto akuza të përafrohen dhe të urëzohen në këtë mënyrë në nivel lokal? Kjo e bën të pakuptimtë", thotë Ymeri për Radion Evropa e Lirë (REL). Për njohësin tjetër të çështjeve politike, Agon Maliqi, këto koalicione, që po bëhen

kryesisht në komuna të vogla, nuk tregojnë për ndonjë trend. Sipas tij, partitë detyrohen të bëjnë kompromise që ua dikton realiteti, që të mos ketë acarime brenda degëve. "Ka prijes lokalë që kanë prioritete tjera prej nivelit qendror, dhe ata mendojnë ndryshe, ndërsa niveli qendror është shpesh në pozitë që, nëse ua prish qejfin, le të themi, rrezikon ta humbë gjithë degën, ajo të shkrihet në një parti tjetër", thotë Maliqi për REL-in.

Mospajtimet e qendrave partiake për koalicionet

Lajmet për koalicionet nuk u pranuan lehtë nga qendrat e disa partive. Shembull, vetë kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, doli kundër marrëveshjes së arritur mes LDK-së dhe LV-së në Vushtrri. "Reagimi i selisë më shumë ka pasur të bëjë me mënyrën se si u shpall koalicioni, me prezencën e Kurtit aty, që e krijoi një efekt nacional. U perceptua prej LDK-së si poshtëruese, apo si presion i LV-së ndaj LDK-së për negociatat që mund t'i kenë pasur për nivelin qendror", vlerëson Maliqi. Edhe Time Kadrijaj nga AAK-ja tha publikisht se për koalicionet me LV-në nuk ka qenë në dijeni selia, dhe i ka dënuar ato. Partitë nuk ishin të qasshme

kur REL-i provoi të merrte nga një koment prej tyre. Ymeri beson se ndonëse asnjëra parti politike nuk duket se ka autonomi të plotë në degët e veta, kryetarët e degëve duhet t'i kenë parasysh interesat e gjithë partisë. "Degët e partive politike nuk duhet të harrojnë se janë pjesë e një partie politike, e cila nuk e ka në këndvështrim vetëm njërin prej komunave, por tërë të ardhmen e partisë". Sipas tij, jo rrallëherë këto koalicione lidhen për interesa personale, për ndarje të pushtetit në nivel lokal, i cili jo domosdo e ka interesin e qytetarit si synim të parë. Për Ismet Kryeziun, drejtor ekzekutiv në Institutin Demokratik të Kosovës, partitë nuk mund ta ndajnë me thikë qeverisjen kombëtare nga ajo lokale. "Cila është logjika politike nëse në nivelin kombëtar përçahen, armiqësohen dhe nxisin pothuaj përplasje civile, ndërsa në nivel lokal sillen sikur janë bashkëpunuese për të mirën e qytetarit? Nuk mund t'i lësh qytetarët një vit pa institucione, pa Kuvend e pa qeveri funksionale, e pastaj të thuash se në komuna po bashkëpunojmë për nevojat e tyre", u shpreh ai në Facebook. Balotazhi do të zhvillohet në 18 komuna. Tjerat i kanë zgjedhur kryetarët e vet qysh në raundin e parë, më 12 tetor. Vëmendjen kryesore më 9

nëntor pritet ta marrin garat në Prishtinë (LDK - LV), Prizren (PDK - LV), dhe Mitrovicë të Jugut (LV - PDK).

Çfarë i ul tensionet partiake?

Partia që fitoi më së shumti vota në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, LV-ja, provoi ta formonte qeverinë e re të Kosovës më 26 tetor, por pa sukses. Meqë edhe partitë tjera të mëdha shqiptare u deklaruan se nuk i kanë numrat për ta krijuar një shumicë, Kosova duket se i ka të pashmangshme zgjedhjet e parakohshme. Rruga prej shkurtit deri në fund të tetorit ishte e mbushur me akuza të panumërta dhe polarizime të skajshme. Të shumtë janë ata që kanë dilema nëse procesi i ri eventual do të prodhonte rezultate të reja. Për njohësit e çështjeve politike, çelësi qëndron te ndryshimi radikal në qasje. "Rezultati mund të mos ndryshojë, por sjellja e partive politike duhet të ndryshojë, karshi nevojës urgjente që Republika e Kosovës e ka për të pasur institucione funksionale. Ne si qytetarë, duhet ta kuptojmë qartë që përgjegjësia bie mbi palët që e kanë pasur mundësinë dhe pushtetin më të madh", vlerëson Ymeri.

Ndërtimi i hekurudhës Shkodër - Gjakovë mund të nisë brenda 2-3 viteve të ardhshme

PRISHTINË, 31 TETOR - “Financimi për ndërtimin e hekurudhës Shkodër - Gjakovë pritet të sigurohet përmes një kombinimi instrumentesh, duke përfshirë financime nga donatorë të ndryshëm, si dhe kontribute kombëtare nga Shqipëria dhe Kosova”. Kjo sipas Hekurudha

Shqiptare, që e cilëson këtë model financimi të kombinuar, të aplikuar tashmë me sukses në projekte të tjera hekurudhore. “Ky model ofron fleksibilitet për të mbuluar një projekt të përmasave të tilla”, kanë deklaruar nga Hekurudha Shqiptare për “TV Scan”.

Sipas studimit të fizibilitetit kostot për këtë segment hekurudhor përlogariten në 1.8 miliardë euro. Rreth 1.7 miliard euro janë kosto që nevojiten për ndërtimin, ndërsa pjesa tjetër përlogariten si kosto për leje, shpronësime, etj. Linja hekurudhore nga

Shkodra në Gjakovë do të ketë 7 stacione, në një gjatësi prej 105.8 km. Segmenti do të përmbajë 43 ura dhe 14 tunele, teksa gjatësia totale e tuneleve është 35.3 km. Projekti pritet të ketë një kohëzgjatje prej rreth 12 vitesh nga fillimi i projektimit deri në operimin e plotë.



BQK-JA MBAN PUNËTORINË INFORMUESE MBI KORNIZËN RREGULLATIVE PËR LICENCIMIN E OPERATORËVE TË SHËRBIMEVE TË KRIPTO-ASETEVE

PRISHTINË, 31 TETOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka organizuar punëtorinë informuese me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve dhe palëve të interesit në fushën e krypto-aseteve, me fokus prezantimin e kornizës rregullative për licencimin e operatorëve të shërbimeve të krypto-aseteve me aktivitet këmbimi. Drejtori i Departamentit për Mbikëqyrjen e Tregjeve, IMF, IFJB, IP, IPE dhe Kripto-aseteve, Sokol Shasivari, duke hapur punimet e kësaj punëtorie, prezantoi kornizën rregullative dhe adresoi pritjet mbikëqyrëse të BQK-së, si dhe hapat e radhës në procesin e licencimit. Përfaqësuesit e BQK-së theksuan se rregullimi i këtij segmenti do të zhvillohet në mënyrë graduale dhe të kujdesshme nga BQK-ja, me qëllim integrimin e aktiviteteve të krypto-aseteve në një mjedis të licencuar dhe të

mbikëqyrrur, duke ruajtur stabilitetin financiar të vendit dhe mbrojtjen e konsumatorit në veçanti. Rregullorja për Licencimin e Operatorëve të Shërbimeve të Kripto-Aseteve, e miratuar nga BQK-ja në bazë të Ligjit Nr. 08/L-295 për Kripto-Asetet dhe e harmonizuar me parimet e kornizës së BE-së për Tregjet e Kripto-Aseteve (MiCA), vendos themelet për krijimin e një tregu të rregulluar dhe transparent të krypto-aseteve në Kosovë. Kjo përfshin si këmbimin e krypto-aseteve, qoftë me paratë fiat (përfshirë ATM-të) apo me krypto-asete të tjera, brenda një kornize të qartë ligjore dhe mbikëqyrëse, gjë që shënon hapin e parë drejt licencimit të operatorëve të krypto-aseteve, ndërsa do të pasohet nga zhvillime të tjera rregullative në përputhje me planin strategjik të BQK-së për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij



sektori. Gjatë punëtorisë u prezantuan elementet kryesore të kësaj kornize, përfshirë kriteret për aplikim, marrje dhe mirëmbajtje të licencës; Kërkesat prudenciale, përfshirë qeverisjen korporative dhe kërkesat për kapital; Detyrimet për transparencë ndaj klientëve dhe veprim me ndershmëri dhe

profesionalizëm; Zbatimi i masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT); dhe masat korrigjuese dhe administrative që aplikohen në rast të mospërmbushjes së kërkesave rregullative. U trajtua gjithashtu faza pas licencimit, ku operatorët e krypto-aseteve do t'i nënshtrohen

mbikëqyrjes së vazhdueshme nga BQK-ja, me fokus në respektimin e kriterëve prudenciale dhe mbrojtjen e fondeve të klientëve. Gjatë punëtorisë u potencua se kjo qasje është zhvilluar në komunikim dhe informim edhe të autoritetet të tjera përgjegjëse brenda vendit dhe me mbështetjen teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në kuadër të përpjekjeve për forcimin e kornizës ligjore dhe mbikëqyrëse në fushën e krypto-aseteve. Në përmbyllje të punëtorisë, u theksua se BQK mbetet e përkushtuar ndaj forcimit të kornizës ligjore dhe mbikëqyrëse, ruajtjes së stabilitetit financiar si dhe nxitjes së zhvillimit të një tregu të qëndrueshëm të krypto-aseteve në Kosovë, duke garantuar transparencë, integritet të tregut dhe mbrojtje të konsumatorit, në pajtim me praktikatat më të mira evropiane.

KONGRESI INCOSAI, SPANCA NË DISKUTIMIN GLOBAL PËR PAVARËSINË E INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT



PRISHTINË, 31 TETOR - Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca dhe zëvendësauditori i përgjithshëm, Beza Halilaj morën pjesë në sesionin e nivelit të lartë me temën “Sfidat informale për pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit”, organizuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI), në kuadër të punimeve ndërkombëtare të INCOSAI-t. Ky sesion diskutimi me

pjesëmarrjen e krerëve të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA) dhe përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare adresoi faktorët informale që ndikojnë në pavarësinë e ISA-ve përtej kornizave ligjore, përfshirë pritjet politike, reputacionin institucional, dinamikat fiskale dhe marrëdhëniet me palët e interesit. Gjatë sesionit u diskutua se si faktorët më lart ndikojnë në aftësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit për të ushtruar

mandatin e tyre në mënyrë të pavarur dhe efektive. Po ashtu, pjesëmarrësit shkëmbyen përvoja mbi mënyrat e forcimit të besueshmërisë publike dhe integritetit institucional. Në kuadër të këtij sesioni u prezantuan gjetjet e para të Projektit Global për Pavarësinë e ISA-ve i udhëhequr nga OECD dhe IDI, që synon të analizojë ndikimet e faktorëve politikë, ekonomikë dhe institucionalë në pavarësinë reale të ISA-ve në mbarë botën.

AKB-ja shënon 23-vjetorin e themelimit, vlerësohet kontributi i saj në zhvillimin ekonomik të vendit

Prishtinë, 31 tetor- Në praninë e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, trupave diplomatike, bizneseve vendore, partnerëve ndërkombëtarë dhe miqve nga të gjitha trojet shqiptare, Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka shënuar 23-vjetorin e themelimit. Kreu i AKB-së, Agim Shahini, ka theksuar se ky përvjetor

simbolizon rrugëtimin e qëndrueshëm të Aleancës Kosovare të Bizneseve, e cila për më shumë se dy dekada ka dhënë një kontribut të çmuar në zhvillimin ekonomik të vendit, fuqizimin e sektorit privat dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërshtetëror. Edhe në fjalimet dhe urimet e

kësaj dite u vlerësua roli aktiv i AKB-së në krijimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe institucioneve, si dhe në thellimin e partneriteteve me përfaqësues diplomatike dhe organizatat ekonomike në rajon e më gjerë. Aleanca Kosovare e Bizneseve ka shprehur mirënjohje të veçantë

për të gjithë miqtë, bashkëpunëtorët dhe institucionet që ndanë këtë përvjetor të rëndësishëm dhe riafirmon përkushtimin për të vijuar misionin e saj në shërbim të zhvillimit ekonomik, bashkëpunimit rajonal dhe përfaqësimit dinjitoz të biznesit kosovar.



NGA BURGU TE BETEJAT BRENDË PS, KARRIERA DHE JETA POLITIKE E FATOS NANOS!

Ka ndërruar jetë këtë të premte, 31 tetor, ish-kryeministri i Shqipërisë, Fatos Nano



Ish-kreu i Partisë Socialiste, 73 vjeç, ndodhej në reanimacion prej gati 1 muaji, në një spital në kryeqytet.

Nano u shkëput nga politika në vitin 2005 dhe ka qenë kryeministër gjatë viteve 1991, 1997-1998 dhe 2002-2005. Ai ishte themeluesi i Partisë Socialiste dhe kreu i parë i saj.

Kush ishte Fatos Nano, “arkitekti” i Partisë Socialiste: Fatos Nano ishte kryeministër i Shqipërisë tre herë. Ndërsa për 13 vjet, ishte kryetar i Partisë Socialiste.

Nano e mbajti detyrën e kryeministrit nga 29 shtator 2002-1 shtator 2005, 25 korrik 1997-27 shtator 1998, 22 shkurt 1991-4 qershor 1991. Ndërsa si kryetar i Partisë Socialiste ai e mbajti këtë detyrë nga 12 qershori 1991 deri më 3 korrik 2005.

Fatos Nano e nisi karrierën e tij politike në vitin 1991, pasi u zgjodh Kryeministër i Qeverisë

së Tranzicionit, me qëllim që të organizonte zgjedhjet e para demokratike në Shqipëri, në po atë vit dhe të përgatiste vendin për tranzicionin drejt një ekonomie tregu dhe sistemi demokratik. Zgjedhjet e 31 marsit 1991 u fituan nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe ai u caktua përsëri Kryeministër. Pas dy muajsh, ai u detyrua të jepte dorëheqje. Atë vit, ai u zgjodh kryetar i Partisë Socialiste, e cila ishte pasardhëse e Partisë së Punës së Shqipërisë.

Në mars të vitit 1992, Partia Demokratike fitoi zgjedhjet dhe një vit më pas, Fatos Nano u burgos, pasi u akuzua për korrupsion dhe abuzim detyre nga gjykata. Burgosja e tij u bë problemi kryesor i Shqipërisë postkomuniste, sepse shumë socialistë besonin se kjo burgosje ishte pasojë e opozicionit të Nanos ndaj qeverisë së

Berishës.

Gjatë vitit 1994, skemat piramidale po bëheshin të njohura në Shqipëri dhe rënia e tyre në vitin 1997 shkaktoi një revoltë të armatosur, të nxitur nga opozita kundër qeverisë, me kërkesën për kthimin e parave të humbura në firmat piramidale. Kjo revoltë çoi në shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme nga presidenti i asaj kohe, Sali Berisha. Nano u lirua nga burgu pas një amnistie të dhënë nga Berisha. Zgjedhjet u fituan nga Partia Socialiste. Berisha dha dorëheqjen dhe Kuvendi i ri zgjodhi president Rexhep Mejdani. Presidenti Mejdani emëroi kryeministër Fatos Nanon.

Në shtator të vitit 1998, vrasja e Azem Hajdarit çoi në një revoltë popullore dhe e detyroi Fatos Nanon të jepte dorëheqjen. Fatos Nano u gjykua i pafajshëm nga një gjykatë në Tiranë ndaj akuzave për shpërdorim

detyre dhe korrupsion në vitin 1999.

Partia Socialiste vazhdoi qeverisjen e vendit dhe fitoi zgjedhjet në qershor 2001. Nano u bë Kryeministër për të tretën herë në korrik 2002, i emëruar nga presidenti Alfred Moisiu. Më 3 korrik 2005, Partia Socialiste humbi zgjedhjet dhe shumicën në parlament. Partia Demokratike fitoi shumicën dhe kryetari i saj, Sali Berisha, u emërua Kryeministër i qeverisë së re. Më 1 shtator 2005, Nano dha dorëheqjen si kryetar i Partisë Socialiste.

Nano kërkoi të zgjidhej si president më 8 korrik 2007, pas mbarimit të mandatit të presidentit Moisiu. Shumica e deputetëve të opozitës, të drejtuar nga Partia Socialiste, nuk e përkrahën kandidaturën e tij dhe bojkotuan zgjedhjet.

Si deputet i Parlamentit Shqiptar, Nano ka shërbyer

zonën e Kuçovës, Tepelenës dhe Sarandës.

Fatos Nano studio në gjimnazin “Sami Frashëri” në Tiranë. Kreu studimet e larta në Universitetin e Tiranës (Fakulteti i Ekonomisë).

Në vitin 1975, kreu specializimet për Ekonomi Politike. Në vitin 1983, me vendimin nr. 81, datë 23 shtator 1983, të Universitetit të Tiranës, mori titullin “Doktor i Shkencave” në fushën e ekonomisë, ndërsa në vitin 2000, titullin “Profesor Doktor” në fushën e ekonomisë.

Nga Universiteti Ndërkombëtar i Milanos (Itali), në vitin 2000, u dekorua me titullin “Doktor Honoris Causa” në fushën e Ekonomisë dhe Teknikës së Komunikimit, dhe po në këtë vit, mori titullin e nderit “Doktor Honoris Causa” në fushën e shkencave ekonomike, nga Universiteti i Barit (Itali).

HISTORIA ËSHTË NJË TAPICERI ME GJYSMË TË VËRTETA DHE FOLKLOR



Nga: Alice LOXTON
(The Telegraph)


Vini re! Vini re! Një tjetër “fakt historik” është rrëzuar! Sipas një kërkimi që shpërthen fluskat - kryer nga Muzeu Gjerman i Historisë së Mjekësisë - imazhi i frikshëm i mjekut me maskën me sqep, gjatë Murtajës së Zezë, në fakt është një mit. Kjo nuk është hera e parë që trillimet e tilla janë ngulitur si fakte në imagjinatën publike. Njohuria jonë për të kaluarën është e mbuluar me shtresa të panumërta gjysmë të vërtetash dhe me folklor, të romantizuara përmes pikturave madhështore dhe poezisë epike. Ndoshta më i madhi ndër të gjithë: Vikingët mbanin helmata me brirë. Nuk ka asnjë dëshmi bashkëkohore për këtë. Ideja lindi shumë shekuj më vonë, me ciklin e operave

Unaza të Richard Wagnerit, të frymëzuara nga personazhet e sagave nordike. Në vitet 1870, stilisti i kostumeve, Carl Emil Doepler - me shije për dramë të madhe - krijoi helmata me brirë madhështorë, të denjë për një lopë malore. Kështu, në imagjinatën publike një gënjeshtër u kthye në fakt. Një tjetër trill është se Napoleoni ishte i shkurtër. Në të vërtetë, ai ishte mbi gjatësinë mesatare dhe ndoshta më i gjatë se Nelsoni [admirali anglez Horatio Nelson]. Në vitin 1815, një kapiten anglez e përshkroi atë si “një burrë jashtëzakonisht i fuqishëm, i ndërtuar mirë”. Atëherë, nga erdhi ideja për shtatin e tij të shkurt? Nga satirat thumbuese të grafistëve londinezë si James Gillray dhe Thomas Rowlandson. Puna e tyre kishte shumë ndikim - madje ishte “çmenduri e vërtetë” kur një karikaturë e re shfaqej në

dritaret e dyqaneve të Pikadilit, duke shkaktuar një histeri të ngjashme me atë bitëlmanisë. Duke u ushqyer nga ankthi i Luftërave të Napoleonit, ata krijuan një personazh të ri, fiktiv - “Boni i Vogël”, një fëmijë histerik. Aq i vogël ishte, saqë fshihej pas kapelës së tij gjigante me pupla dhe mezi qëndronte ulur në karrige me këmbët që i lëkundeshin lirshëm. Kjo fushatë propagandistike ishte aq efektive saqë, edhe sot, në imagjinatën popullore ne mendojmë për karakterin gilraik [të krijuar nga James Gillray], jo për vetë njeriun [Napoleonin]. Një vit pas vdekjes së Napoleonit, në vitin 1822, Mbreti George IV bëri një vizitë në Edinburg - vizita e parë e një monarku në veri në 172 vjet. Ishte një ekstravagancë luksoze, e organizuar nga Sir Walter Scott, “një skenë që i tejkalonte të gjitha triumfet e kohëve të lashta apo moderne”.

Një moment kyç ndodhi kur Mbreti George veshi rrobat malësore - një fustanellë me kuadrate [tartan kilt], çuditërisht të shkurtër, i kombinuar me çorapet rozë për të fshehur këmbët e zbuluara. Edhe pse fustanella ishte veshur nga klanet skoceze që nga shekulli XVI, spektakli i Scottit popullarizoi një ide romantike të identitetit kombëtar skocez - ndihmuar nga letërsia e tij, me përshkrime të fustanellës, veshjeve malësore dhe peizazheve të bukura. Shumë keqkuptime rezultojnë nga keqkuptimi i dëshmive të mbetura. Zbulimi i rrënojave greke dhe romake - ato blloqe të zhveshura prej guri - bëri që paraardhësit tanë ta perceptonin botën e shumëngjyrtë klasike si një pamje të zbehtë bardhezi. E njëjta gjë mund të thuhet për Mesjetën. Me kalimin e shekujve, ngjyrat

në arkitekturën mesjetare janë zbehur, dhe ne paramendojmë se ishin pa dekorime. Por, një kështjellë mesjetare ishte plot ngjyra, e mbuluar me modele vibrante. Interierët e tillë - të rikrijuara së fundmi në Kalanë e Norviçit - janë të ndritshme për shijen moderne, duke u përplasur me idetë tona të botëve të imagjinuara mesjetare. Larg së qenit i gdhendur në gur, kuptimi ynë për të kaluarën është në ndryshim të vazhdueshëm, i ridrejtuar nga kostumet e operave apo karikaturat satirike. Por, këtu qëndron rëndësia e hetimit historik: të shtursh dhe të qepësh sërish shumë fije të një tapicerie që ndryshon gjithnjë. Siç demonstron nga Muzeu Gjerman i Historisë së Mjekësisë, historia nuk është kufomë, por diçka e gjallë dhe aktive. Nuk ka nevojë për mjekë të murtajës këtu. /Telegrafi/



SUPERLIGA E BASKETBOLLIT NË FUNDJAVË: DERBI MES SKUADRAVE TË PAMPOSHTURA

PRISHTINË, 31 TETOR - Java e katërt në ProCredit Superligë do të jetë me shumë sfida interesante. Derbi i kësaj jave është ndërmjet Bashkimit dhe Sigal Prishtinës, dy skuadrave që në tri ndeshjet e para kanë shënuar tri fitore.

Prizrenasit marrin pjesë në FIBA Europe Cup, kurse prishtinasit në Ligën ENBL, duke e bërë këtë sfidë edhe më të bukur. Ndeshjet mes këtyre dy skuadrave kanë qenë gjithmonë interesante dhe kështu pritët edhe në sfidën

hapëse të kësaj jave që zhvillohet sot (e shtunë). Takim po ashtu interesant shihet ndërmjet Trepçës dhe Golden Eagle Yllit. Kampionia dhe ish-kampioni nuk e kanë nisur aq mirë edicionin e ri, me një fitore e dy humbje në edicionin e ri.

Nesër (e diel), GO+ Peja që ka tri fitore e pret Rahoveci 029, në një sfidë interesante në 'Karagaçi'. Vreshtarët kanë një fitore e dy humbje. Java e katërt mbyllet me ndeshjen Vëllaznimi-Bora, që ende nuk

dinë për fitore në tri xhirot e para, duke e bërë këtë përballje shumë interesante me të dy skuadrat që kërkojnë fitoren e parë.

PROCREDIT SUPERLIGA-JAVA 4

Sot (e shtunë)
17:00 Bashkimi – Sigal Prishtina
19:00 Trepça – Golden Eagle Ylli

Nesër (e diel)
17:00 GO+ Peja – Rahoveci 029
19:00 Vëllaznimi – Bora



PRISHTINA 01 TRIUMFON NDAJ KAMPIONIT TË KROACISË DHE SIGURON VENDIN NË 'ELITE ROUND'

PRISHTINË, 31 TETOR - Skuadra kampione e Kosovës, Prishtina 01 ka shënuar një fitore ndaj kampionit të Kroacisë, Novo Vrijeme, duke siguruar vendin e tretë në Grupin 4 dhe kualifikimin në mesin e 16 skuadrave më të mira të Ligës së Kampionëve të futsallit në "Elite Round". Pas humbjes së rëndë 19:1 ndaj Sportingu portugez, dy herë fitues i Ligës së Kampionëve, Prishtina 01 reagoi me një paraqitje fantastike dhe triumfoi 7:6 ndaj skuadrës kroate, nikoqire e ndeshjeve të këtij grupi.

Ndeshja e zhvilluar në Makarska është vendosur në sekondat e

fundit, kur Ramadan Alaj ka realizuar golin e fitores vetëm një minutë para fundit të takimit. Alaj, një nga lojtarët më të mirë të futsallit në Kosovë, ka shënuar golin vendimtar për suksesin e kryeqytetasve. Halim Selmanaj ka kontribuar me tre gola, ndërsa Arif Limani, Jeton Rukovci dhe Fitim Krasniqi kanë shënuar nga një gol secili.

Për këtë fitore dhe sukses, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka uruar lojtarët e Prishtina 01. "Ky sukses tregon karakterin dhe përkushtimin e kampionëve tanë dhe është një mundësi e mirë për të fituar përvojë edhe më të madhe, duke qenë në



mesin e 16 skuadrave më të mira të Evropës. Përgëzoj të gjithë lojtarët dhe stafin e FC Prishtina 01 për një paraqitje të tillë dhe për një rikthim të fuqishëm pas humbjes në ndeshjen e parë ndaj njëres prej top-skuadrave

evropiane, Sporting Lisbonë. Sukses e mbarësi edhe në sfidat e ardhshme!", ka shkruar Ademi në "Facebook". Kryeqytetasit do të përballen sot (e shtunë) me Kairat Almaty të Kazakistanit, ndërsa Novo

Vrijeme do të ndeshet me Sportingun, por pa gjasë për të kaluar tutje. Tri skuadrat e para të çdo grupi avancojnë në "Elite Round". Pas dy ndeshjeve të para, Sporting ka siguruar vendin e parë dhe avancimin si lider me gjashtë pikë, ndërsa Kairat Almaty dhe Prishtina 01 janë në luftë për vendin e dytë, secila me nga tre pikë. Novo Vrijeme mbetet në vendin e fundit pa pikë dhe pa mundësi për t'u kualifikuar. Shorti për fazën e nokaut do të tërhiqet më 6 nëntor, ndërsa finalja e këtij edicioni të Ligës së Kampionëve të futsallit do të zhvillohet në Pesaro, Itali.

GRANIT XHAKA MAHNIT PREMIER LEAGUEN, LIDER ABSOLUT TE SUNDERLANDI

LONDËR, 31 TETOR - Granit Xhaka po kalon një periudhë fantastike në Premier League. Me Sunderland, ekipi që vetëm këtë sezon u ngjiti në elitën e futbollit anglez, mesfushori i Kombëtares zvicerane po përjeton një valë suksesi të papritur. Pas një fillimi të shkëlqyer sezonal, "Black Cats" renditen ndër katër skuadrat më të mira të kampionatit dhe një pjesë e madhe e meritës mban firmën e kapitenit të



tyre, Granit Xhaka. Sipas të dhënave të publikuara nga "BBC", Xhaka kryeson pothuajse çdo statistikë të rëndësishme brenda skuadrës. Ai ka realizuar më shumë pasime brenda zonës, ka krijuar më shumë raste për gol, ka fituar më shumë duele fizike, ka rikuperuar më shumë topa dhe ka bërë numrin më të madh të pasimeve në total. Me pak fjalë, 33-vjeçari është zemra dhe truri i lojës së

Sunderlandit. Edhe në rang lige, kontributi i Xhakës është mbresëlënës: ai ka përshkuar më shumë kilometra se çdo lojtar tjetër në Premier League këtë sezon, një arritje e jashtëzakonshme për një futbollist në moshën e tij. Me profesionalizëm dhe përkushtim shembullor, Granit Xhaka po e udhëheq Sunderlandin drejt një sezoni që tashmë po quhet "histori suksesi" në futbollin anglez.

Juventusit dhe Zhegrova bëhen me trajner të ri, "Zonja e Vjetër" prezanton Luciano Spallettin

Torino, 31 tetor - Juventus ka zyrtarizuar emërimin e Luciano Spallettit si trajner i ri i skuadrës, me një kontratë që do ta mbajë në "Allianz Stadium" deri më 30 qershor 2026. Ai ka nisur rrugëtimin si trajner të Empoli, duke e çuar klubin nga Serie C në Serie A

dhe duke fituar Kupën e Italisë për këtë kategori, një sukses që e bëri menjëherë të njohur për stilin e tij modern dhe inovativ. Në fillim të viteve 2000, Spalletti është afirmuar te Udinese, duke siguruar për herë të parë në historinë e klubit kualifikimin në

Champions League (2004/05). Më pas, Spalletti kishte kaluar te Roma, ku ka fituar dy herë Kupën e Italisë dhe një Superkupë Italiane. Ndërmjet viteve 2009-2014, ai ka drejtuar Zenit St. Petersburg, me të cilin fitoi dy tituj kampion, një Kupë të Rusisë dhe një

Superkupë. Pas rikthimit në Itali, Spalletti qëndroi në krye të Romës dhe Interit, përpara se të udhëhiqte Napolin drejt titullit kampion të Serie A në sezonin 2022/23. Së fundmi, ai ishte trajner i kombëtares italiane deri në qershor të këtij viti.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përqaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Risa Trade” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b UNIK: 812139526 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTEN.JE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Risa Trade" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812139526 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Risa Trade” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812139526 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fitor Sadiki shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.
- Ilirjana Likaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Mitat Frasheri” Kraj.
- Besart Collaku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Mitat Frasheri” Kraj.
- Donjeta Collaku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Mitat Frasheri” Kraj.
- Fortesa Collaku shpall te pavlefshme dëftesat e kl I – IX.
- Muharrem Shala shpall të pavlefshme diplomën si dhe dëftesat e shkollës fillore “Mustafa Bakija”.
- Albatros Manxhuka shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Nikoll Kazazi”.
- Shqiprim Morina shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “12 Maji”.
- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.
- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.
- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.
- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.
- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.
- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

